



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:036029
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05676252

Ac.nr.692/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.H. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.I. avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Novobërdë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, me objekt kontesti, kompensimin e shujtave, shpenzimet e udhëtimit dhe punës shtesë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.41/2020 të datës 01.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna Novobërdë -Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.41/2020 të datës 01.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

‘I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.H. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Novobërdës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të borxhit të pa paguar për ushqim të ngrohtë t’ia paguaj shumën prej 854 euro, për shpenzime të udhëtimit shumën prej 579.80 euro dhe për punën shtesë në paralelet e kombinuara shumën prej 2,189.20 euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 3,623.00 euro, në lartësi të kamatës prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë me datë 06.03.2020 e deri në pagesën definitive

të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II.DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të autorizuarit të paditësit t'ia paguaj shumën prej 384 euro në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm''.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, pa cekur një për një shkaqet e ankimit, por me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta hedhë poshtë dhe lënda të kthehet në rigjykim në mënyrë që kjo barrë t'i transferohet Qeverisë së Kosovës, si nënshkruese e kësaj kontrate.

Në përgjigje në ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet, ndërsa e paditura të obligohet në shpenzimet e procedurës edhe për këtë përgjigje në padi sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi me datë 06.03.2020, kundër të paditurës. Me parashtrësës për precizim të datës 24.09.2020, i autorizuari i paditësit ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të shujtave ditore për periudhën prej 18.04.2017 deri më 11.03.2020, për 427 ditë pune të ia kompensoj nga 2 euro në ditë, në emër të shpenzimeve të udhëtimit në vlerë prej 70% të biletës së udhëtimit për çdo ditë pune për këtë periudhë, t'ia paguaj shumën prej 579.80 euro, si dhe duke qenë se paditësi mbanë mësim me klasat e kombinuara të paguhet me 20% të pagës së rregullt, që për 26 muaj sipas pagës 421 €x20%, që i bie 84.20 €, periudhën prej 18.04.2017 deri më 11.03.2020, me kamatë dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, përgjigjes në padi të të paditurës, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm përkitazi me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga nenit 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në vendin e punës në cilësinë e mësimdhënësit tek ShFMU “Hanumshahe dhe Tefik Zymeri”, në Pasjak – gjegjësidht paralelja në fshatin M.U., Komuna Novobërd, fakt i vërtetuar sipas Kontratës së punës me kohë të pacaktuar të datës 01.09.2018. Po ashtu nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë prezentë në punë prej datës 14.04.2017 deri më 11.03.2020, dhe ka punuar gjithsejtë 427 ditë pune, fakt i vërtetuar nga vërtetimi nr.61/20 i datës 12.09.2020 dhe se i njëjti gjatë kësaj periudhe ka udhëtuar në relacionin Gjilan-M.U. Ndërsa nga çmimorja e Shoqatës Transportuese e udhëtarëve “A.” e datë 08.01.2020, është vërtetuar se bileta e transportit një drejtim kushton 1.00 euro, dhe kthyses 2.00 euro. Nga vërtetimi nr.109/2019 i dt.30.12.2019 është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura me normë të plotë në ShFMU “Hanumshahe dhe Tefik Zymeri”, në Pasjak dhe në paralelen në fshatin M.U. që do thotë mban mësim me klasë të kombinuar, gjithsej 20 orë normale dhe 5 orë të kombinuar në paralelen M.U.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të së paditurës, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me: dispozitën e nenit 67 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L -212 datës 01.11.2010 , përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndemjet a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata , marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: në a) nivel të vendit, b) në nivel të degës, c) nivel të ndërmarrjes , Me paragrafin 3 te këtij neni përcaktohet se “Marrëveshja duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 4 përcaktohet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me dispozitën e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 është e paraparë se: *‘Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune dy (2)euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në Institucionet Arsimore. Punëdhënësi i cili e ka rregulluar*

ushqimin e të punësuarve ,përmes restorantit apo kuzhinës ose në ndonjë formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Ndërsa me nenin 35 paragrafin 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcaktohet se: *”Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.*

Me nenin 11 par. 3, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcaktohet se: *”Mësimdhënësit që punojnë me klasa të kombinuara duhet të kompensohen për 20% mbi pagën e rregullt”.*

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë, duke e detyruar të paditurën, që paditësit në emër të shujtave ditore, shpenzimeve të udhëtimit e cila llogaritet për periudhën prej datës 19.04.2017 deri më 11.03.2020, si dhe punës shtesë për mësim klasor të kombinuar, t’ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërbllimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç janë vërtetimet për ditët e pranisë në punë, vërtetimi nga kompania e udhëtimeve dhe vërtetimi për mësimin klasor të kombinuar të lëshuara nga e paditura, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë,

në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.692/2021, me datë 13.05.2024

**Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.**